



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Nr. 7392/prot.
2

Tiranë, më 27.01.2022

Lënda: Njoftim me shpallje publike

Z. ARTUR ZOTO

Tiranë

Bazuar në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nenet 63, gërma "a" dhe 66, pika 2 dhe pika 4, gërma "b", Vendimin nr. 118, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së", i ndryshuar, Kreu X, pikat 1 dhe 2, Vendimin nr. 124, datë 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil", i ndryshuar, Kreu III, pika 26, si dhe në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Departamenti i Administratës Publike (DAP), ka nxjerr aktin për përfundimin e marrëdhënies suaj në shërbimin civil dhe si anëtar i Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues me nr. 7392 prot., datë 31.12.2021.

Rezulton se, posta shqiptare, ka kthyer aktin tuaj të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, me shënimin "Adresë e Pamjaftueshme". Meqenëse njoftimi nuk është i mundur, si dhe çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur, në zbatim të nenit 162 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vendosëm të procedojmë me njoftimin publik me shpallje të aktit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, respektivisht në faqen e internetit të DAP-it, në një kënd të posaçëm pranë këtij institucioni, si dhe në njësinë administrative ku rezulton vendbanimi juaj.

Sa më lart, afishojmë njoftimin publik me shpallje në këndin e institucionit të DAP-it, për një afat 10-ditor, nga data 27.01.2022, deri në datën 07.02.2022.



DREJTOR DEPARTAMENTI

Albana Koçiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Nr. 882/ prot.

Tiranë, më 31.12.2021


Lënda: Përcillet vendimi nr. 38, datë 31.12.2021 i Departamentit të Administratës Publike

Z. ARTUR ZOTO

Tiranë

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nenet 63, gërma "a" dhe 66, pika 2 dhe pika 4, gërma "b", si dhe Vendimin nr. 118, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së", i ndryshuar, Kreu X, pikat 1 dhe 2, gjeni bashkëlidhur aktin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil dhe si anëtar i Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,



DREJTOR DEPARTAMENTI

Albana Koçiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBBIMIN CIVIL

Nr. 332 prot.

Tiranë, më 31 .12. 2021

VENDIM

“Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, nëpërmjet lirimit nga shërbimi civil të z. Artur Zoto”

Nr. 38, datë 31 .12. 2021

Bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenet 63, gërma “a” dhe 66, pika 2 dhe pika 4, gërma “b”, Vendimin nr. 118, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, Kreu X, pikat 1 dhe 2, Vendimin nr. 124, datë 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, i ndryshuar, Kreu III, pika 26, si dhe në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Departamenti i Administratës Publike (DAP);

VËREN SE:

Me Vendimin nr.7, datë 16.02.2015 të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues “Mbi rezultatin përfundimtar”, në përfundim të konkursit kombëtar për anëtarë të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND), Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes (KPP) ka shpallur fitues z. Artur Zoto. Në zbatim të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, Kreu VI, pikat 3 dhe 4, si dhe në vijim të Vendimit nr. 7, datë 16.02.2015 të KKP-së, Departamenti i Administratës Publike emëroi z. Artur Zoto me aktin nr. 648/8 prot, datë 20.02.2015, nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues dhe anëtar të TND-së.

Mbështetur në nenin 30 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Anëtarët e TND-së mund të caktohen në çdo pozicion të rregullt të kategorisë së lartë drejtuese, të përcaktuar sipas pikës 4 të nenit 19 të këtij ligji, apo të caktohen koordinatorë të posaçëm. 2. Plotësimi i një vendi të lirë të kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore mund të bëhet vetëm me një anëtar të TND-së. Çdo emërim i kategorisë së lartë drejtuese, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë ligj, është absolutisht i pavlefshëm...”. Ndërkohë, në pikën 6 të po këtij neni përcaktohet se: “6. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për menaxhimin dhe lëvizjen e anëtarit të TND-së.”.

Në vijim të dispozitave të mësipërme ligjore, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr.118, datë 05.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, në Kreun VII të së cilit sanksionohet lëvizshmëria e anëtarëve të

TND-së, emërimi i tyre në pozicion të rregullt drejtues në administratën shtetërore, apo të nivelit të mesëm drejtues, emërimi dhe lirimi i tyre në pozicion të nivelit të lartë drejtues në institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore, rregullat që aplikohen mbi pagesat financiare ndaj tyre, etj.

Konkretisht, sa i takon emërimin apo caktimin të një anëtarit të TND-së në një pozicion të rregullt drejtues (pozicion të nivelit të lartë drejtues në administratën shtetërore), akti i sipërcituar nënligjor në pikat 3 dhe 4, të Kreut VII, të tij përcakton se:

“3. Emërimi në një pozicion të rregullt apo si koordinator i posaçëm, në përputhje me pikën 1 të kreut VII të këtij vendimi, bëhet nga DAP-i sipas kërkesës së titullarit të institucioneve respektive.

4. Titullari i institucioneve respektive, sipas pikës 3 të këtij kreu, është:

a) Kryeministri, për çdo pozicion të rregullt në Kryeministri apo në institucionet e varësisë së Kryeministrit;

b) ministri, për çdo pozicion të rregullt në ministri apo në institucionet e varësisë së ministrit;

c) Kryeministri, zëvendëskryeministri apo ministrat respektivë, për pozicionet e koordinatorit të posaçëm në grupet institucionale apo ndërinstitutionale, ose në projekte të posaçme që janë nën përgjegjësinë e tyre.”.

Nga të dhënat e administruara pranë Departamentit të Administratës Publike rezulton se, z. Artur Zoto ka mbajtur pozicionin Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe është liruar nga ky pozicion më shkresën nr. 4180/4 prot., datë 15.07.2016 të Departamentit të Administratës Publike. Rezulton se nga momenti i lirimit e deri më sot që anëtarit i TND-së ka qenë në pritje për tu caktuar në një pozicion të rregullt drejtues, nuk është depozituar asnjë kërkesë nga titullarët e institucioneve respektive (Kryeministër, ministër, apo Zv.Kryeministër) për emërimin/caktimin në një pozicion të rregullt drejtues në administratën shtetërore.

Në këto kushte, bazuar në pikën 2, të Kreut X, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike vëren se, për nëpunësin, z. Artur Zoto, njësia përgjegjëse ndodhet në kushtet e zbatimit të nenit 66, pika 2 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas të cilit anëtarit i TND-së lirohet nga shërbimi civil kur nuk është caktuar në një pozicion të rregullt drejtues për të paktën, 8 (tetë) muaj në një periudhë 5-vjeçare. Theksojmë se, afati 5-vjeçar ka filluar nga momenti i lirimit të tij si anëtar i TND-së dhe është tejkaluar gjatë kohës që DAP po shqyrton kryerjen e këtij veprimi administrativ.

Sa më sipër, mbështetur nënnet 63, gërma “a” dhe 66, pika 2 dhe pika 4, gërma “b”, Vendimin nr. 118, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, Kreu X, pikat 1 dhe 2, Vendimin nr. 124, datë 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, i ndryshuar, Kreu III, pika 26, Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse për të deklaruar lirimin e anëtarit të TND-së nga shërbimi civil.

VENDOSI:

1. Të deklarojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, nëpërmjet lirimit nga shërbimi civil, për z. Artur Zoto, për shkak se anëtar i TND-së nuk është caktuar në një pozicion të rregullt drejtues për të paktën, 8 (tetë) muaj në një periudhë 5-vjeçare.
2. Të njoftohet z. Artur Zoto për këtë vendimmarrje të njësisë përgjegjëse.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga e nesërmja e marrjes dijani.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR DEPARTAMENTI



Albana Koçi